

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

MUST SH.P.K.

Sot, më datë 12/09/ 2024

Denis ZOI, lindur ne Durres, i datëlindjes 07.05.1992, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, me numër identifikimi J20507081K

Mario LIKA, lindur ne Durres, i datëlindjes 20.10.1990, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, me numër identifikimi J01020080G

kane përpiluar këtë Akt themelimi të Shoqërisë tregtare "MUST" SH.P.K., me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare "MUST" SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin " MUST" SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

Krijim, hostim, domain dhe mirëmbajtje për website dhe software te ndryshem, si dhe menaxhimi i tyre. Ofrimi i shërbimeve digitale dhe IT. Aktivitete te progamimit informatik dhe te menaxhimit te instalimeve informatike. Konsulencë në fushën e teknologjisë së informacionit. Këshillim për platformat e administrimit të biznesit dhe platformat digitale. Konsulencë për transformimin digital të kompanive dhe digital marketing.



Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

DURRES,Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Shkozet, Zona Kadastrale 8516, objekt me nr.pasurie 13/314

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100.000 (njeqindmije) lekë dhe përbehet nga 2(dy) kuota.

Denis ZOI është zotërues i 1 kuote, me 50 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 50.000 leke.

Mario LIKA është zotërues i 1 kuote, me 50 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 50.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë


Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.



Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjecar, me te drejte riemerimi..

Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Mario LIKA, për një afat 5 vjecar,

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqerise. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKET THEMELUES

Denis ZOI



Mario LIKA

